



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

KOMUNIKATË

29.10.2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e sotshme të nr. 48-të (2009) ka shqyrtuar dhe miratuar një agjendë të gjërë të detyrave të veta. Mbledhjen, e ka kryesuar Kryetarja znj. Nesrin Lushta. Pasi që është agjenda raporti i kësaj mbledhje, Kryetarja Nesrin Lushta ka paraqitur aktivitetet e veta më të fundit në emër të KQZ-së:

Më datën 22 tetor, Kryetarja Nesrin Lushta, ka nënshkruar Marrëveshjen për donacion me Ambasadën Gjermane në shumë prej 40,510 euro që ka të bëjë me Qendrën Mediale. KQZ shprehë faliminderime sepse ky donacion dukshëm do të ndihmoj ngritjes së transparencës dhe efikasitetit të punës së KQZ dhe SKQZ. OSBE, gjithashtu i ka dhënë KQZ-së një gjenerator, i cili do të shërbej për raste emergjente, për ka kryetarja Lushta ka shprehur mirënjohje dhe falenderim.

Më datën 22 tetor, KQZ-në e kanë vizituar Presidenti i Kosovës, Kryeministri i Kosovës dhe Ambasadori Amerikanë. Ata kanë shprehur mirënjohje për punën e KQZ dhe SKQZ, dhe kanë premtuar përkrahje edhe në të ardhmen për organizimin e suksesshëm të zgjedhjeve të lira dhe demokratike.

Më datën 23 tetor, KQZ-në e ka vizituar Misioni i EU-së (Unioni Evropian), i cili mision do të ketë rol të rëndësishëm në vëzhgimin e zgjedhjeve të 15 Nëntorit 2009.

Më datën 27 tetor, në selinë e KQZ-së, Kryetarja Nesrin Lushta është takuar me Ambasadorin e Republikës së Hungarisë, i cili ka treguar interesim për rrjedhjen e përgaditjeve të zgjedhjeve dhe, ka ofruar bashkëpunim kudo që është e nevojshme.

Më datën 28 tetor, Kryetarja Lushta, ka marrë pjesë në ceremoninë e dhënies së betimit të anëtarit të ri të KQZ-së, Abdylhadi Krasniq te Presidenti i Kosovës.

Në vazhdim të mbledhjes, Kryeshefi i SKQZ-së Xhemajl Peqani, ka informuar për takimet që ka pasur me Policinë e Kososës, KFOR-in, Policinë e EULEX-it, OSBE-në dhe IFES-in lidhur me koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta për sigurinë e procesit zgjedhor. Gjithashtu, kanë filluar edhe trajnimet për Këshillat e Vendvotimeve në shumicën e komunave dhe deri të dielen, do të bëhet funksionalizimi i QNR-së me infrastrukturë dhe staf teknik.

Kryeshefi Xhemajl Peqani ka informuar se së shpejti do të bëhet përzgjedhja e Operatorit për Qendren Mediale, se është kryer prodhimi i Fletëvotimeve dhe i Listës së Kandidatëve në Slloveni nga kompania CETIS, ka filluar shtypja e LPV-ve nga kompania Dukagjini, ka filluar edhe shtypja dhe prodhimi i materialit zgjedhor për Loton e tretë, e ku hyjnë llampat, spreji i gishtit, kabinat e votimit dhe lidhëset e sigurisë nga ana e kompanisë Kopenhagen Elecion A/S nga Danimarka. Po ashtu, është nënshkruar edhe marrëveshja me Rektoratin e UP-së, lidhur me shfrytëzimin e Sallës Solemne të Fakultetit Filologjik për Qendren Mediale.

Kryeshefi Peqani, ka informuar KQZ-së se, është në fazën finale të planit operacional për distribuimin e materialit zgjedhor sensitiv dhe jo sensitiv në depot e ZE të KKZ-së në të gjitha komunat. Prej datës 07, deri më 08 nëntor, do të filloj trajnimi i votuesëve me nevoja të veqanta në Vushtrri, si dhe do të finalizohet së shpejti LPV, e cila do t'i ofrohet në mbledhjen e radhës KQZ-së për t'u certifikuar.

Kryeshefi Peqani, ka informuar se, prej datës 02, deri më datën 06 nëntor, zyra e Auditorit Gjeneral, do të bëjë auditimin e SKQZ-së. Ndërsa, në periudhën prej datës 15 tetor, deri më datën 27 tetor, janë bërë 1033 kërkesa nga subjektet politike për tubime kurse, janë mbajtur mbi 648 tubime të fushatës zgjedhore.

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike, ka paraqitur rekomandimet për akreditim të vëzhguesëve që do të marrin pjesë në zgjedhjet e 15 nëntorit. Drejtoresha e ZRPP-së znj. Miradije Mavriqi, ka informuar se deri më 28 tetor, janë proceduar aplikacionet e vëzhguesve për procesin zgjedhor të tetë (8) subjekteve politike, të pesë (5) organizatave ndërkombëtare, të tetë (8) ambasadave dhe të një (1) OJQ-je nga Kosova me gjithsej 5.572 vëzhgues. Gjithashtu, deri më 28 tetor janë proceduar aplikacionet e vëzhguesve për ditën e zgjedhjeve nga gjithsej 9 subjekte politike, me gjithsej 365 vëzhgues.

Zyra, i ka rekomanduar KQZ-së që të bëjë akreditimin e organizatave të vëzhguesve dhe të vëzhguesve të tyre me gjithsej 5.937 vëzhgues. KQZ ka aprovuar këto rekomandime të ZRPP-së. Deri më tani, KQZ ka akredituar gjithsej 16.015 vëzhgues.

KQZ ka shqyrtuar edhe rekomandimin e ZRPP-së për mosmiratimin e kërkesave për largim nga Listat e subjekteve politike të kandidatëve për Këshilltar Komunal pas kalimit të afatit ligjor. KQZ ka aprovuar rekomandimin e ZRPP-së që kandidatët Vjosa Shabani (PSDK), Zhivković Ivica (SKMS) Mile Zhivković (SKMS) dhe Burhan Rexhepi (ORA) të mos largohen nga Llista, pasi që afatet ligjore nuk e mundësojnë një gjë të këtillë.

Në vazhdim të mbledhjes, janë shqyrtuar edhe detyra të Këshillave të KQZ-së. Këshilli i Buxhetit dhe Prokurimit, e ka informuar për Draft-Vendimin për pagesat e KVV-ve, i cili vendim është miratuar. KQZ ka diskutuar edhe për AID-it dhe, ka vendosur që anëtarët KVV-ve të jenë të paisur me ID që do të përmbajnë fotografi personale të volitura të anëtarëve të KKV-ve.

KQZ ka diskutuar edhe për Shabllonet e Fletëvotimeve për Alfabetin e Braj-it, si dhe mënyra e raportimit të SMS-ve nga IFES-i. KQZ ka kërkuar nga IFES që të siguroj një raport të detajizuar në afat deri të hënen, lidhur me mënyrën e raportimit me SMS për sigurimin e rezultatit preliminar të zgjedhjeve.

Në mbledhjen e sotshme, KQZ ka bërë edhe emrimin e KKV-ve për komunitetet e Graçanicës, të Leposaviq, të Zveçanit dhe të Zubun Potokut.